

VENDIM
Nr. 348, datë 16.6.2021

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit për ndihmat shtetërore të vitit 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RAPORTI VJETOR
PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2020

PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5, të MSA-së dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndhmës Shtetërore për autorizimin e ndihmës shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe të analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore të miratuara sipas vendime të miratuara nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Bashkia e Tiranës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2020, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2014 – 2020, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së.

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesorë që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumenteve kryesore të përdorura në periudhën 2017 – 2020. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri, gjatë viteve 2017 – 2020, është vlerësuar në rreth 48,464.84 milionë lekë (388.54 milionë €), prej të cilave 30,761.82 milionë lekë (248.56 milionë €) që përfaqësojnë 1.96 % të PBB-së, janë dhënë në vitin 2020. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2020, vendin kryesor (rreth 93.76 %) e zënë ndihmat horizontale, ndërsa ndihma sektoriale përbën 6.24 % të ndihmës gjithsej. Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin “*de minimis*” të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2020 janë garancitë shtetërore, grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Raporti Vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2020 do t’i përcillet Komisionit Evropian.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2020

2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2017 – 2020

2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

2.2.1 Ndihma Shtetërore Horizontale

2.2.2 Ndihma Shtetërore Sektoriale

III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore, si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Gjithashtu, neni 71, “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës, të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarra nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 107 (1), të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- Masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;
- Masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar, si edhe
- Masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis shteteve anëtare.

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

- Ndihma për organet publike dhe njësi të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet joekonomik;
- Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme, etj.;
- Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me çmimin e tregut.

1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- Ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;
- Ndihmën për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme;
- Ndihmën për punësim;
- Ndihmën për trajnim;
- Ndihmën operacionale;
- Ndihmën për sportin;
- Ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- Ndihmën për transportin publik;
- Ndihmën për shërbimin publik;
- Ndihmën për infrastrukturën *broadband*;
- Ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente si:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2 - Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore;

A3 - Garancitë Shtetërore.

II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2020

2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2017 – 2020

A. Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socio-ekonomike

Tabela nr. 1


Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socio-ekonomik 2015 – 2020

Treguesit	Niveli i ndihmës	2015	Shkalla e ndihmës 2015	2016	Shkalla e ndihmës 2016	2017	Shkalla e ndihmës 2017	2018	Shkalla e ndihmës 2018	2019	Shkalla e ndihmës 2019	2020	Shkalla e ndihmës 2020
PBB	milione	1,614.3	0.35	1,472.5	0.19	1,551.3	0.24	1,600.9	0.34	1,688.9	0.50	1,572.3	1.96
Të punësuar (15-64-jec)	nr	1,070,826	4.70	1,120,281	2.504	1,150,392	3.302	1,174,834	4.725	1,202,337	7.055	1,243,345	24.741
Rqulisa	nr	2880,703	1.741	2826,101	9.75	2,873,457	1.302	2,866,376	1.937	2,862,427	2.963	2,829,741	10.871
Ndihma shtetërore	milione	5014.99		2826.34		3,798.67		5,551.34		8,482.45		30,761.82	

Burimi: MFE

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri, në periudhën 2015 – 2020, të krahasuara me disa tregues. Ndihma shtetërore gjithsej, në vitin 2020, është dhënë në vlerën totale 30,761.82 milionë lekë (248.56 mln euro). Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u rrit nga 0.5 % në 2019, në 1.96 % në vitin 2020.

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së, për periudhën 2014 – 2020.



Grafiku nr. 1. Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB-në, 2014 – 2020

B. Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe shtetet e Bashkimit Evropian

Tabela nr. 2, paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, për periudhën 2017 – 2018.

Tabela nr. 2

Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së, për periudhën 2017 – 2018

Periudha Shtetet	2017	2018
Shqipëri	0.24	0.34
Belgjikë	0.499	0.788
Bullgari	1.322	0.992
Çeki	1.414	1.601
Danimarkë	1.508	1.552
Gjermani	1.377	1.454
Estoni	0.992	1.022
Irlandë	0.176	0.163
Greqi	0.275	0.299
Spanjë	0.257	0.337
Francë	0.939	0.791
Kroaci	1.239	1.541
Itali	0.24	0.306
Qipro	0.527	0.461
Letoni	1.669	0.997
Lituani	1.111	1.27
Luksemburg	0.255	0.239
Hungari	2.484	1.829
Maltë	1.12	1.217
Holandë	0.321	0.346
Austri	0.49	0.459
Poloni	1.487	1.026
Portugali	0.515	0.449
Romani	0.505	0.545
Slloveni	0.855	0.88
Sllovaki	0.296	0.475
Finlandë	0.828	1.156
Suedi	0.905	0.912
Mbretëria e Bashkuar	0.439	0.38

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition² dhe MFE (%)

² https://ec.europa.eu/competition-policy/state-aid/scoreboard_en.

Shënim. Deri në datën 18 maj 2021, KE-ja ka publikuar të dhënat për ndihmën shtetërore deri në vitin 2018.

2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndhimë shtetërore horizontale; dhe
- Ndhimë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.

Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.


Tabela nr. 3

Ndihma shtetërore gjithsej, 2017 – 2020, ndarë sipas kategorive (në milion lekë)

KATEGORIA	2017			2018			2019			2020		
	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %
Ndihma Horizontale	2,379.88	17.86	63.2%	4,082.54	32.00	74.5%	4,210.44	34.23	49.8%	28,843.57	233.06	93.76%
Punësimi	196.79	1.48	5.2%	111.78	0.88	2.0%	247.73	2.01	2.9%	27.78	0.22	0.1%
Trajnimi	276.98	2.08	7.4%	150.48	1.18	2.7%	98.22	0.80	1.2%	4.01	0.03	0.0%
Sport	218.80	1.64	5.8%	104.01	0.82	1.9%	121.72	0.99	1.4%	125.31	1.01	0.4%
Kultura	39.58	0.30	1.1%	134.00	1.05	2.4%	63.32	0.51	0.7%	93.99	0.76	0.3%
Ndihma operacionale	5.02	0.04	0.1%	1,642.90	12.88	30.0%	1,532.50	12.46	18.1%	27,475.35	222.01	95.3%
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	1,595.38	11.97	42.4%	1,895.98	14.86	34.6%	2,060.24	16.75	24.4%	1,096.00	8.86	3.8%
SME	47.33	0.36	1.3%	43.39	0.34	0.8%	86.71	0.71	1.0%	21.13	0.17	0.1%
Ndihma Sektoriale	1,383.79	10.38	36.8%	1,400.00	10.97	25.5%	4,246.37	34.53	50.2%	1,918.25	15.50	6.24%
Transport publik (Hekurudha)	400.00	3.00	10.6%	400.00	3.14	7.3%	400.00	3.25	4.7%	400.00	3.23	20.9%
Shërbimi publik	974.90	7.32	25.9%	1,000.00	7.84	18.2%	400.00	3.25	4.7%	720.00	5.82	37.5%
Infrastruktura Broadband	-	-	-	-	-	-	491.96	4.00	5.8%	54.25	0.44	2.8%
Turizmi	8.89	0.07	0.2%	-	-	-	2,954.41	24.02	35%	744.00	6.01	38.8%
TOTALI	3,763.67	28.25	100	5,482.54	42.97	100	8,456.81	68.76	100	30,761.82	248.56	100


Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafiku nr. 2. Ndihma shtetërore gjithsej 2017 – 2020



Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafiku nr. 3. Ndihma shtetërore horizontale/ sektoriale 2017 – 2020



Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 3, tregojnë se në vitin 2020 ndihma shtetërore horizontale zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 93.76 %, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 6.24 %.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore, në vitin 2020, u rritën me 24, 633.13 mln lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2019. Ky ndryshim i përgjithshëm është rezultat i faktorëve si: 1. ulje e ndihmës shtetërore për punësimin me 219.94 mln lekë; 2. ulje e ndihmës shtetërore për trajnimin me 94.21 mln lekë; 3. rritje e ndihmës shtetërore për mbështetjen e sportit me 3.59 mln lekë; 4. rritje e ndihmës shtetërore për kulturën me 30.67 mln lekë; 5. rritje e ndihmës operationale me 25,942.85 mln lekë; 6. ulje e ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 964.24 mln lekë; 7. ulje e ndihmës shtetërore për SME-të me 65.58 mln lekë; 8. rritje e ndihmës shtetërore për shërbimin publik (ujësjellësit) me 320 mln lekë; 9. ulje/dhënie e ndihmës për infrastrukturën *broadband* me 437.71 mln lekë; dhe ulje/dhënie e ndihmës shtetërore për sektorin e turizmit prej 2,210.41 mln lekë.

2.2.1 Ndihma Shtetërore Horizontale


Në vitin 2020 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 28,843.57 mln lekë (233.06 mln euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e zë ndihma operationale me 93.76 %.

Tabela nr. 4


Ndihma shtetërore horizontale 2017 – 2020

Ndihma Horizontale	2017		2018		2019		2020	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
<i>Punësimi</i>	196.79	1.48	112.10	0.88	247.73	2.01	27.78	0.22
<i>Trajnim</i>	276.98	2.08	150.48	1.18	98.22	0.80	4.01	0.03
<i>Sport</i>	218.80	1.64	104.01	0.82	121.72	0.99	125.31	1.01
<i>Kultura</i>	39.58	0.30	134.00	1.05	63.32	0.51	93.99	0.76
<i>Ndihma operationale</i>	5.02	0.04	1,642.90	12.88	1,532.50	12.46	27,475.35	222.01
<i>Kërkim, zhvillim dhe inovacion</i>	1,595.38	11.97	1,895.98	14.86	2,060.24	16.75	1,096.00	8.86
<i>SME</i>	47.33	0.36	43.39	0.34	86.71	0.71	21.13	0.17
TOTALI	2,379.88	17.86	4,082.86	32.00	4,210.44	34.23	28,843.57	233.06

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE



Grafiku nr. 5. Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2017 – 2020



Grafiku nr. 6. Struktura e ndihmës shtetërore horizontale në 2020

Ndihma horizontale, në vitin 2020, është në vlerën 28,843.57 mln lekë. Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore jepen më poshtë:

Ndihma për punësim: Ndihma për punësim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale’”.

Në këtë skemë kanë përfituar 243 subjekte, duke punësuar gjithsej 1172 punëkërkues të papunë, si vijon:

- Programi i punësimit 4-mujor: kanë përfituar 3 subjekte, të cilët kanë punësuar 30 punëkërkues të papunë;
- Programi i punësimit 8-mujor: kanë përfituar 125 subjekte, të cilët kanë punësuar 1129 punëkërkues të papunë;
- Programi i punësimit 12-mujor: kanë përfituar 115 subjekte, të cilët kanë punësuar 563 punëkërkues të papunë.

Ndihma për trajnim: Ndihma për trajnim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale’”. Në këtë skemë kanë përfituar gjithsej 337 subjekte, duke trajnuar 1095 punëkërkues të papunë.

Ndihma për sportin: Ndihma për sportin është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 54, datë 26.1.2015, “Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit”. Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i të cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike, duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2020, janë dhënë 125.31 mln lekë.

Ndihma për nxitjen e kulturës: Ndihma për kulturën është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 56, datë 4.6.2015, “Autorizim i ndihmës shtetërore për veprimtaritë, të

mirat dhe shërbimet kulturore”. Në vitin 2020, ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është në vlerën 93.99 mln lekë. Ndihma shtetërore është dhënë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike për projektet, konkretisht: 5 projekte në programin e artit dhe kulturës; 5 projekte në programin e librit; 38 projekte në programin e trashëgimisë kulturore dhe muzetë; 26 projekte të tjera në fushën e kulturës.

Ndihma operationale: Në këtë kategori përfshihen të dhëna të ndihmës shtetërore të autorizuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si vijon:

1. Vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 24, datë 2.5.2008, “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agro-industriale të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”;

2. Vendimin e KNSH-së nr. 96 , datë 27.3.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore ‘COVID-19: Skema mbështetëse në formën e grantit’”;

3. Vendimin e KNSH-së nr. 97, datë 6.4.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore ‘COVID-19: Skema e Garancisë Shtetërore të Huas’”;

4. Vendimin e KNSH-së nr. 98, datë 28.4.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore ‘COVID-19: Skema mbështetëse në formën e grantit 2’”.

Për vitin 2020, dhënësit dhe zbatuesit e ndihmës shtetërore raportojnë si vijon:

- ndihmë shtetërore, në shumën 585.25 mln lekë, nëpërmjet skemës së rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agro-industriale, me përfitues 10 subjekte;

- ndihmë shtetërore, sipas skemës mbështetëse në formën e grantit, në 5,114,77 mln lekë. Përfitues janë ndërmarrjet (çdo person fizik ose juridik privat), me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, që kryejnë veprimtari ekonomike në të gjithë sektorët e ekonomisë, si edhe individët, ndihma për të cilët jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, me përfitues gjithsej 64,574 subjekte;

- ndihmë shtetërore, sipas skemës mbështetëse në formën e grantit 2, në 6,923,4 mln lekë, me përfitues 173,085 subjekte. Përfitues të ndihmës janë:

- të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që kanë mbyllur aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave;

- të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- punonjësit e subjekteve, persona fizikë ose juridikë, që ushtrojnë aktivitetin si struktura akomoduese, të cilët figurojnë në listëpagesa deri në datën e urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- ndihmë shtetërore në skemën e Garancisë Shtetërore të Huas, e miratuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 97, datë 6.4.2020 , nëpërmjet:

- VKM-së nr. 277, datë 6.4.2020, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”, e cila miratoi linjën e garancisë shtetërore, në vlerën 11 000 000 000 (njëmbëdhjetë miliardë) lekë, në favor të bankave të nivelit të dytë, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19; dhe

- VKM-së nr. 387, datë 13.5.2020, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare, për të mundësuar financimin e nevojshëm, për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga COVID- 19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”, e cila miratoi linjën e garancisë shtetërore në vlerën 15 000 000 000 (pesëmbëdhjetë miliardë) lekë, në favor të bankave tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, për të siguruar fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19.

Deri në dhjetor 2020, në bazë të VKM-së nr. 277, datë 6.4.2020 (Garancia Sovrane 1), janë miratuar 492 marrëveshje të garancisë (në shumën 5,901.3 mln lekë), të lidhura mes bankave të nivelit të dytë dhe tregtarëve dhe shoqërive tregtare në sektorët e tregtisë, industrisë përpunuese, prodhimit, shërbimeve, ndërtimit, minierave, turizmit, edukimit, medias, etj.

Deri në dhjetor 2020, në bazë të VKM-së nr. 277, datë 6.4.2020 (Garancia Sovrane 2), janë miratuar 318 marrëveshje të garancisë (në shumën 8, 950.6 mln lekë), të lidhura mes bankave të nivelit të dytë dhe tregtarëve dhe shoqërive tregtare në sektorët e tregtisë, turizmit, prodhimit, ndërtimit, shërbimeve transportit, industrive përpunuese, etj.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim: Ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë “Marrëveshje hidrokarburesh” dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2020, është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfutur përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), në shumën 1,096.0 mln lekë (në vitin 2019 shuma e përjashtimeve ishte 2,060.24 mln lekë).

Ndihma për SME-të: Në këtë kategori përfshihen të dhëna të ndihmës shtetërore të autorizuar me vendim të KNSH-së nr. 81, datë 4.5.2018, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për nxitjen e biznesin rinor’” dhe vendimin e KNSH-së nr. 88, datë 15.3.2019, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes’”. Bashkia e Tiranës raporton dhe vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 21.13 mln lekë, duke përfutur gjithsej.

- Skema e autorizuar me vendim të KNSH-së nr. 81, datë 4.5.2018, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për nxitjen e biznesin rinor’”, me përfutues 20 subjekte.

- Skema e autorizuar me vendim të KNSH-së nr. 88, datë 4.5.2018, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes’”, me përfutues 12 biznese *start up* dhe 8 ndërmarrje ekzistuese.

2.2.2 Ndihma Shtetërore Sektoriale


Në vitin 2020, ndihma shtetërore sektoriale, në vlerë absolute, është 1,918.25 mln lekë (15.5 mln euro). Pesa për këtë kategori në totalin e ndihmës, në vitin 2020, është 6.24 %.

Tabela nr. 5


Ndihma shtetërore sektoriale 2017 – 2020

Ndihma sektoriale	2017		2018		2019		2020	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Transport publik (Hekurudha)	400.00	3.00	400.00	3.14	400.00	3.25	400.00	3.23
Shërbimi publik	974.90	7.32	1,000.00	7.84	400.00	3.25	720.00	5.82
Infrastruktura Broadband	-	-	-	-	491.96	4.00	54.25	0.44
Turizmi	8.89	0.07	-	-	2,954.41	24.02	744.00	6.01
TOTALI	1,383.79	10.38	1,400.00	10.97	4,246.37	34.53	1,918.25	15.50

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE



Grafiku nr. 7. Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2017 – 2020



Grafiku nr. 8. Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2020

Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale), për vitin 2020, peshën kryesore e zë ndihma për turizmin (39 %), shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve) (37 %), duke vijuar me ndihmën për transportin publik (hekurudha) (21 %).

Ndihma për Transportin Publik: e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, është 400 milionë lekë edhe në vitin 2020.

Ndihma për Shërbimet Publike: Në vitin 2020, ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, në shumën 720 mln lekë.

Ndihma për Infrastruktura Broadband: Në bazë të vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 89, datë 23.4.2019, “Autorizimi i Ndihmës Shtetërore për Digjital-Dividentin”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore, ka dhënë ndihmën në vlerën 714 mln lekë. Me mbylljen e transmetimeve analoge dhe kalimin e tyre në numerike, në të 12 qarqet e vendit (më datë 30 dhjetor 2020), kompensimi financiar vijon për subjektet të cilët kanë paraqitur dokumentacionin financiar justifikues, si dhe kanë rezultuar që nuk kanë pasur detyrime financiare (përtej afateve ligjore), sanksione, gjopa të kthyer në titull ekzekutiv të papaguara, përdorim të paautorizuar frekuencash. Nga fondi i vënë në dispozicion për kategorinë e investimeve të kryera nga operatorë privatë, historikë, kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analog në numerik, siç kërkohet nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, janë kompensuar financiarisht 28 subjekte.

Ndihma për turizmin: Në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 82, datë 17.5.2018, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore Për skemën e Incentivave Fiskale në sektorin e Turizmit”, ndihma për sektorin e turizmit nga buxheti i shtetit, për vitin 2020, është përfituar nga strukturat

akomoduese, nga reduktimi i TVSH-së nga 20 % në 6%, për vitin 2020, më përfitues gjithsej 1,291 subjekte në shumën 714 mln lekë.

Në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 74, datë 12.12.2016, “Autorizim i ndihmës shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të projekteve në sektorin e turizmit”, në vitin 2020, janë dhënë 29.93 mln lekë me 9 përfitues. Me urdhër të MTM-së nr. 280, datë 10.11.2020, “Për miratimin e projekteve turistike që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit” janë miratuar projektet turistike, të kualifikuara nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve, që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, si më poshtë vijon:

1. “ALBANIA, THE BEAUTIFUL, Territore dhe Njerëz”;
2. “Shqiptarët e mrekullueshëm II”;
3. “Promovimi i zonave të mbrojtura”;
4. “Reklamimi i kalave dhe njohja e audiencës me historinë e tyre”;
5. “Kultura, Mjeshtëria dhe Turizmi një Partneritet Vital”;
6. “Evidentimi dhe promovimi i shtigjeve të *hiking* në Shqipëri”;
7. “Tirana 100”;
8. “Krijimi i një databaze për hotelerinë në Shqipëri”;
9. “Modele për zhvillimin e aktiviteteve të turizmit detar, planifikimi dhe projektimi i aktiviteteve në zonat bregdetare”.

III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike, duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2019, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-JA, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

- A1 - Subvencione dhe grante;*
- A2 - Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;*
- B - Pjesëmarrja në kapital;*
- C1 - Hua të buta;*
- C2 - Instrumente të tjera;*
- D - Garancitë.*


Tabela nr. 6

Ndihma Shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Ndihma Shtetërore	Subvencione dhe Grante (A1)	Përfshirje nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)	Garanci Shtetërore (A3)
Ndihma Horizontale			
Punësimi	27.78		
Trajnim	4.01		
Sport	125.31		
Kultura	93.99		
Ndihma operationale	12,038.17	585.53	14851.92
Kërkim, zhvillim dhe inovacion		1,096.00	
SME	21.13		
Ndihma Sektoriale			
Transport publik (Hekurudha)	400.00		
Shërbimi publik	720.00		
Infrastruktura	54.25		
Broadband			
Turizmi		744.00	
TOTALI	13,484.64	2,425.53	14,851.92

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Instrumenti i përdorur më shumë është A3 - Garancitë shtetërore (48 %), ndjekur nga A1 - Subvencione dhe grante (44 %), dhe A2 - Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritja e kontributit në sigurimet sociale (8 %), sikurse paraqitet edhe në grafikun nr. 8.



Grafiku nr. 8. Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2020